

VENDIM
Nr.677, datë 4.10.2006

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I RRUGËS BERAT-BALLABAN, PRISHUR SI
PASOJË E SHKARJEVE NË FSHATIN REHOVË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i rrugës Berat-Ballaban, prishur si pasojë e shkarjeve në fshatin Rehovë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 750 m² tokë bujqësore, të vlerësuar me 700 lekë/m², në shumën e përgjithshme prej 525 000 (pesëqind e njëzet e pesë mijë) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 112 500 (njëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 525 000 (pesëqind e njëzet e pesë mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri “Shpronësimet”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 20.11.2006.
 7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**PRONARI QË DO TË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I RRUGËS BERAT-BALLABAN, PJESË E
SHKARJEVE NË FSHATIN REHOVË**

Nr.	Emri	Pasuria	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi në lekë për m ²	Vlera në lekë
1	Syrja Vesel Jacaj	nr.693/2	3163	750 m ²	700	525 000

Vlera totale e këtij shpronësimi është 525 000 (pesëqind e njëzet e pesë mijë) lekë.